



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-6993 dt. 19/02/ 2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 31.01.2025, duke filluar në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani dhe deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 26 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri - Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Kosovare Halilaj- Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Egzona Qorri (LDK), Mergim Pirraku (DD).

Munguan: Beqir Kiqina (AAK), Labinot Halilaj (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Mergim Pirraku (DD), Muhamet Kurtaj VV.

Të pranishëm ishin edhe: Kryetar i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Arben Shala nënkryetar i Komunës së Drenasit dhe drejtorë të drejtorive. Prezent ishin 18 anëtarë të Kuvendit Komunal.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 30.12.2024;
2. Propozim-vendimi për ndryshim-plotësimin e Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;
3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit me nr.02-400/01-57008, dt. 29.11.2024 për miratimin e Raportit të komisioneve komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
4. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për vitin 2024;
5. Raporti financiar janar-dhjetor 2024;
6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim rendin e ditës me pikën shtesë dhe rendi i ditës kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **1**. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit më 31.12.2024, pasi nuk pati vërejtje as diskutime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e parë me **17 vota” Për”, Kundër ”0”, Abstenim”1”**, kaloi edhe pika e parë e rëndit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **2**. Propozim-vendimi për ndryshim-plotësimin e Rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Egzona Terdevci, tha se 30 ditë kohë pas pranimit të faturës, por edhe pagesa është 30 ditë kohë e jo brenda vitit fiskal siç ka qenë në fillim, për mua është pak paradoksale 30 ditë afati i pagesave dhe 30 ditë afati i ankesave, pra qysh mundet brenda 30 dite me paguar edhe me ankuar nuk ka sens është dashtë me e lënë 30 ditë afatin e ankesave, kurse 45 ditë afatin e pagesave. Ne si asamblistë kemi pranuar shumë ankesa prej bizneseve për taksen që e konsiderojnë të pa drejtë afati i pagesave ishte dashtë me qenë brenda vitit fiskal jo brenda 30 ditëve këtë pjesë. Kisha dashtë me ndryshuar dhe është një paradoks të kodet e reja që janë shtuar marrja me qira dhe dhënia e lizingut pajisjeve të transportit ujorë është 150 euro. Është edhe marrja me qira e lizingut dhe pajisjeve të transportit, sallonet e floktarisë e kanë 200 euro e kanë ngarkesën, për mua është paradoksale që do biznese shumë të vogla me pas taksa më të mëdha, kurse bizneset e transportit ajror edhe pse e di që nuk ka në Drenas me pas taksë më të lirë.

Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, tha se për pikën e parë shumë e cili më pak sepse raportet e fund vitit për çdo biznes evidentohen kush ka qarkullim më shumë kush më pak.

Violeta Baleci, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket pikës 13.2.8 dua të ju sqaroi afatin që e kontestuat me herët 30 ditësh është për dy arsye. Në momentin që ti e faturon ofertën automatikisht programi ta faturon afatin e pagesës 30 ditë dhe afati për ankesa sipas ligjit të procedurës administrative është 30 ditë.

Sa i përket programit të taksës jemi në procedurë për me i bërë disa modifikime edhe me angazhuar një operator në mirëmbajtje të programit, po për derisa ajo është në procedurë mundemi me thënë që për momentin është 30 ditë, ligji thotë që prej 30 ditësh e andej mundesh me dërguar në procedurë përmbarimore.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dytë me **23 vota” Për”, Kundër ”2”, Abstenim”0”**, kaloi edhe pika e dytë e rëndit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **3**. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit nr.02-400/01-57008, më 29.11.2024 për miratimin e Raportit të komisioneve komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Egzona Terdevci, tha se në nëntor na keni sjell shumën 251,874,00 mijë euro, në janar ka ardhur shuma 215,304.87 euro, por shuma reale është 206,776,91 euro. Unë kam kërkuar qasje në dokumente publike e kam marrë raportin e dëmeve janë tri raporte prej tri komisioneve të

ndryshme nëse i mbledhë këto tri totale përveç nëse keni gabuar të totali shuma del 206,772.91 euro, vetëm dua të dimë a e keni kalkuluar mirë shumën se me gjasë duhet me u ndryshuar prapë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Bujqësisë Anita Avdullahu, tha se sipas informatave që kam nga komisioni vetëm të shuma përfundimtare është bërë një gabim teknik dhe për atë arsye e kemi sjellë që të duhen diçka informata shtesë mundesh me u drejtuar edhe të komisioni.

Pasi nuk pati vërejtje as diskutime. **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani**, hodhi në votim pikën **tre me 22 vota” Për”, Kundër ”0”, Abstenim ”0”, kaloi edhe pika e tret e rëndit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **4**. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes lokale për vitin 2024. Pasi nuk pati vërejtje as diskutime, kalojmë te pika e radhës, sepse raportet nuk votohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **5**.
Raporti financiar janar-dhjetor 2024.

Egzona Terdevci, unë i kam dy pyetje të raporti financiar të hyrat nga kodi 66310, shitja e pasurisë publike në tre mujorin e tretë kur është prezantuar raporti për shtator ka qenë 15,000,119,21 euro, tash për tërë vitin 6271 s’po kuptoj a keni bërë gabim diçka dhe në raport asnjëherë nuk po përfshihen llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, a bënë me ditë edhe në si asamblist sa ka borxh Komuna e Drenasit dhe sa kanë borxhe të tjerët ndajë Komunës.

Drejtoresha e Drejtorisë së Financave Albulena Saliuku, përshëndetje për të gjithë, sa i përket kodit që e parashtrori pyetjen znj. Terdevci, këtë kod veç se e kemi sqaruar në seancën e kaluar dhe të gjitha informatat i keni në formë tabelare dhe në formë të shkruar.

Egzona Terdevci, unë nuk kërkova sqarim për kodin se çka bëhet fjalë, po qysh mundet për 9 muaj me kanë shuma më e madhe së për tërë vitin, a ka mundësi me ditë se qysh për 9 muaj janë 15 mijë euro të hyra, ndërsa për krejt vitin 6271 të hyra.

Zyrtari kryesor financiar Kushtrim Bajraktari, e nderuar edhe në seancën paraprake është sqaruar që është bërë një gabim teknik të faturimi edhe ajo pjesë e të hyrave ka pasur të bëjë me Drejtorinë e Urbanizmit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, vazhdojmë me pikën e radhës, sepse raportet nuk votohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën **6**. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesja e Komitetit Antigona Bucolli, paraqet Reportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në pika të shkurtra.

Kryesuesja e Komitetit Antigona Bucolli, përshëndetje për të gjithë, dua të them se Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit, publikon këtë raport vjetor, me qëllim që të mbajmë të informuar të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit lidhur me punën dhe aktivitetet e realizuara dhe mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2024.

Ky organ drejtues institucional i formuar për herë të dytë në Komunën e Drenasit, si qëllim prioritar i këtij komiteti është të sigurojë përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke nxitur dhe siguruar mundësinë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara në territorin e Komunës së Drenasit t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, vazhdojmë me pikën e radhës, sepse raportet nuk votohen.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 7.


Të ndryshme.

Pasi nuk pati vërejtje, diskutime dhe sugjerime mbledhja përfundoi në ora 11:40.

Më gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 31.01.2025 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të Komunës, në rrjetin social.

<https://ëëë.facebook.com/komunadrenas/videos/2502095836805312>

Procesmbajtësja



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani